



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4926 Prot.

Himarë, më 03.07 2026

VENDIM

Nr. 37, DATË 30.06.2026

“PËR MIRATIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT PËR EKONOMITË PYJORE “GJOMOLLË DHE PAPADHI – ÇIPIN”.

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, neni 11, pika 2, gërma b, sipas citimit “.. për të gjitha format e pronësisë planet e mbarështimit miratohen nga Ministri. Përfshijmish për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës..”, të udhëzimit nr.01, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor kombëtar”. Mbështetur në kontratën e shërbimit, lidhur ndërmjet Bashkisë Himarë dhe subjektit “**Lurimi**” sh.p.k, Dibër-Burrel, Shqipëri, me NIPT: **J68403912U**, përfaqësuar nga administrator Lutfi Miftari, me objekt “Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore “Gjomollë dhe Papadhi–Çipin”. Bashkia Himarë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe drejtorisë së bujqësisë, të pyjeve, të kullotave dhe të ujitjes (sektori i pyjeve dhe i kullotave), pasi u shqyrtua relacioni i përgatitur nga ky sektor ku është argumentuar teknikisht dhe ligjërish, Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 30.06.2026 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, miratoi me 15 vota pro , 0 kundër , 0 abstenim,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e mbarështimit të ekonomisë pyjore “Papadhi– Çipin dhe Gjomollë”, të hartuar nga subjekti “*Lurimi*” sh.p.k. me NIPT: **J68403912U**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë, drejtoria e bujqësisë e pyjeve, e kullotave dhe e ujitjes dhe drejtoria e financës, e planifikimit të buxhetit dhe e menaxhimit të aseteve.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI I KËSHILLIT

Dhimitër Kapaj

